

[Varësia...

...ka shumë fytyra

Këshillimorja e varësisë në Zug është këtu për Ju.

Sjellja gjatë varësisë...

Varësia ka shumë shkaqe dhe forma të paraqitjes. Ne njohim konsumimin abuzues ose të varësisë së drogave legale dhe ilegale ose të substancave që të bëjnë të mvarësh prej tyre. Edhe loja, ngrënja ose puna mund të bëjnë të mvarur.

Në fillim abuzimi i substancave të varësisë mund të jetë një provë, që të fitohen përvoja të reja me vetveten, ose në këtë mënyrë të durohen situata të rënda në jetë. Kjo mënyrë e zgjidhjes së problemeve mundet të sjellë problemin e varësisë. Vështirësitë në marrëdhënie me njerëzit, në vendin e punës dhe problemet financiare janë pasoja të saj. Tentimi që vet të lirohesh nga varësia, shpeshherë dështon. Mossukseset, konfliktet ose zemërimi shpiejnë gjithnjë e më shumë deri tek rikthimi i varësisë.

Ekzistojnë rrugë, të cilat të nxjerrin nga ky qorrsokak. Cirkulimi i ndërprerjes dhe i rikthimit mund të ndalet.

Tek Këshillimorja e varësive në Zug mund të marrin informata dhe përkrahje të rinjtë dhe të rriturit me probleme të varësive si dhe personat që kanë të bëjnë me ta, në rast të:

- rrezikimit nga varësia
- abuzimit dhe varësisë nga substancat e varësisë (p.sh. alkooli, medikamentet, nikotina, heroina, kokaina, drogat e ahengjeve)
- sjelljes së mvarshme (probleme me ngrënje, varësia e lojës, e internetit ose e punës)

Ekzistojnë rrugë, të cilat nxjerrin nga varësia.

...Oferta e këshillimit

Oferta jonë e këshillimit përfshin bisedat në raste krize, këshillime të shkurta si dhe këshillime afatgjata dhe terapi. Ne këshillojmë edhe persona, të cilët momentalisht nuk mund ta paramendojnë një jetë pa substanca varësie. Ne ofrojmë:

- Këshillim dhe terapi ...
 - Biseda për individë, çifte dhe familje
 - Programe në kuadër të pirjes së kontrolluar të alkoolit
 - Oferta grupore
 - Sqarim dhe përkrahje gjatë shkuarjes në një program të shhelmimit dhe të rehabilitimit
 - Përkujdesja dhe trajtimi pasues gjatë përfundimit të terapisë stacionare
 - Zbatimi i masave ambulante në lidhje me varësinë (neni 44 i Kodit Penal)
- Intervenim në rast krize
- Ofertë shkollimi për njohjen e hershme të problemeve të varësisë në shkolla dhe ndërmarrje
- Përkrahje dhe këshillim të institucioneve, ekspertëve dhe të interesuarve
- Informacione profesionale / Medioteka

Një ekip i ekspertëve me përvojë nga lëmia e psikologjisë dhe e punës sociale ju përkrahë dhe bashkë me Ju kërkon zgjidhje për ndryshimin e sjelljes në rast të varësisë.

Ne e kemi obligim të heshtim dhe oferta jonë është falas.

Ne ju përkrahim gjatë kërkimit të zgjidhjeve.

...këshillimi Zug]

Na kontaktoni!

Telefoni 041 728 39 39

Orari i punës:

Ditëve të punës nga ora 9.00 deri 12.00

Dhe ora 13.15 deri 17.15

Pas lajmërimit paraprak me telefon bisedat këshilluese janë të mundshme edhe jashtë orarit të punës.

Suchtberatung Zug

(Këshillimorja e varësisë)

Ägeristrasse 56, 6300 Zug

Telefoni 041 728 39 39, faksi 041 728 24 63

suchtberatung@gd.zg.ch, www.zug.ch/sucht

Kanton Zug  Gesundheitsdirektion

Një shërbim i Drekcionit të Shëndetësisë të Kantonit të Zugut



albanisch